

## Editorial

# Fetvaja Islame

Nga Mustafa TËRNIQI

Allahu i Madhëruar në Kuranin Famëlartë thotë: "Pyesni ata që dinë nëse nuk dini!" (El-Enbija: 7)

Ajeti i mësipërm tregon qartë se njerëzit duhet të pyesin dijetarët për gjërat e paqarta dhe për çështjet rreth të cilave nuk kanë informacion dhe as dituri. Në gjuhën e shariatit islam, dijetari që u jep përgjigje pyetjeve të ndryshme për çështjet e fesë quhet mufti, ndërsa përgjigja e tij quhet fetva, ndërsa pyetësi nuk është gjë tjetër vetëm se imitues i tij, që quhet ndryshe në arabisht edhe si mukalid.

Natyrisht jo çdo besimtar mund të jap fetva, kjo detyrë i përket vetëm dijetarëve të mëdhenj e të afirmuar në dije. Në kohën e sotme mufti quhet ai person, i cili përcjell thëniet dhe rregullat e një prej katër medh'hebeve të njohura të fikhut islam, në një çështje të caktuar, në varësi të pyetjes. Në mjaft raste, si në vendin tonë muftiu është vetëm një figurë administrative, që emërohet për të administruar pronat dhe vakëfet islame, për mbarëvajtjen e riteve fetare dhe marrëdhëniet me publikun dhe bashkësitë e tjera jo-islame. Në rastin më të mirë muftitë e sotëm nuk bëjnë gjë tjetër veçse përcjellin thëniet e imamëve të njohur, shpesh pa ditur edhe argumentimin për të dhe në shumë raste pa e kuptuar as vetë thelbin e asaj fetvaje që po përcjellin. Pra në realitet edhe ata vetë janë imitues (mukalidin), ndërkohë shumë prej dijetarëve islamë kanë përmendur se imituesit nuk i lejohet të përcjellë fetvatë e tjetër kujt pa njohur më parë mënyrën e argumentimit të kësaj fetvaje. P.sh. vetë imam Ebu Hanifë ka thënë: "Askujt nuk i lejohet të përcjellë thëniet e mija pa ditur se nga ku i kam marrë." (Ka si qëllim faktin se si është argumentuar dhe ku është mbështetur për të thënë këtë gjë.)

Muftiu i vërtetë në fenë islame është ai dijetar, i cili ka njohuri të thella në gjuhën arabe, në komentin e Kuranit, Sunetin e Profetit (alejhi salatu ue salam), në fetvat dhe thëniet e sahabëve, tabiinëve, në mospajtimet mes dijetarëve të medh'hebeve dhe çfarë është më kryesore, ka njohuri të bollshme rreth disiplinës së Usuli Fikhut, ku ai di si të veprojë me argumentet në formë të përgjithshme. Pra, pasi t'i njohë argumentet e shariatit përgjithësisht, duhet të dijë se a kanë ardhur ato për një kohë të caktuar, vend dhe njerëz të caktuar, apo janë për çdo kohë, për çdo vend dhe për çdo bashkësi..., si dhe plot rregulla të tjera që i përmbledh disiplina e Usuli Fikhut (Bazat e Fikhut). Pikërisht për këtë arsye termi mufti është i barabartë me termin muxhtehid, imam, fakih etj. Kjo do të thotë se sot është vështirë të gesh mufti të mirëfilltë. Kësisoj duhet pasur kujdes e duhet kuptuar përgjegjësia e madhe për dhënien e fetvave. Sot është tejet i përhapur fenomeni i ngutjes në dhënien e fetvave, ku shumë prej atyre që japin fetva mendojnë se janë të ditur dhe në bazë të saj flasin. Profeti (alejhi salatu ue salam) ka pasur me mijëra sahabë, dhe ata kanë pasur fatin ta dëgjojnë atë drejtpërdrejt, mirëpo diçka më shumë

se njëqind vetë prej tyre ishin ata që jepnin fetva. Muftitë më të njohur prej tyre, që kanë dhënë fetva më shumë se të tjerët ishin vetëm shtatë, ata qenë: Omer ibn Hatabi, Ali ibn Ebi Talibi, Abdullah ibn Mesudi, Aishja, Zejd ibn Thabiti, Abdullah ibn Abasi dhe Abdullah ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre). Kjo tregon se ata ishin tepër të rezervuar në dhënien e fetvave, madje në shumë transmetime tregohet se sahabët dhe tabiinët në mjaft raste kanë heshtur dhe nuk kanë dhënë përgjigje. Ndërkohë sot vëmë re një numër tepër të madh njerëzish e hoxhallarësh të cilët japin fetva dhe u përgjigjen të gjitha pyetjeve menjëherë, pa u menduar gjatë e pa hulumtuar rreth çështjeve për të cilat pyeten.

Veç kësaj, mungesa e përdorimit të rregullave të Usuli Fikhut (Bazave të Fikhut) bën që në shumë raste këta mufti të jenë kontradiktorë me vetveten dhe të ndryshojnë mënyrën sesi procedojnë në dhënien e përgjigjeve, duke i ndryshuar edhe mendimet e tyre herë pas here. Kjo gjë natyrisht që sjell çrregullime në mesin e besimtarëve. Po ashtu është konstatuar fakti se shumë njerëz u përgjigjen të gjitha pyetjeve pa përgjashtim, duke kërkuar të privatizojnë xhematin dhe kthyer atë në klientelë ekskluzive të tyre. Ndërkohë imam Ahmed ibn Hanbeli për këtë thoshte: "Dijetarit nuk i lejohet t'i tërheqë njerëzit rreth vetes së tij." Kurse Abdullah ibn Mesudi thoshte: "Ai që i përgjigjet çdo pyetje vërtet është njeri i marrë."

Duhet të dimë gjithashtu se çështjet të cilat kërkojnë përgjigje ndahen në dy lloje: çështje të hershme që janë sqaruar prej kohësh, që në tre shekujt e parë të nderuar të Islamit dhe çështje të reja bashkëkohore. Për çështjet e vjetra duhet përgatitje akademike e tillë, që hoxha i cili pyetet të arrijë të dallojë sipas forcës së argumentit, se cili mendim është më i fortë dhe së fundi të jap përgjigjen e duhur, pasi e ka hulumtuar mirë çështjen. Kjo gjë kërkon prej tij të njohë mirë gjuhën arabe, të ketë njohuri të bollshme në disiplinën e Usuli fikhut dhe të njoh mendimet e dijetarëve të vjetër si dhe mospajtimet mes tyre, përfshi këtu dhe argumentet e secilit prej tyre. Në këtë mënyrë ai mund të japë një përgjigje të studiuar dhe të argumentuar. Ndërsa në rastin e problemeve dhe dukurive të reja si dhe çështjet e ndryshme bashkëkohore, të cilat kërkojnë zgjidhje dhe përgjigje të ndryshme, nuk duhet nxituar, por duhet parë se çfarë kanë thënë komisionet akademike islame të dijetarëve dhe përfundimet e tyre. Këto komisione janë të shumta, por më i njohuri dhe më i madhi ndër to, ku mblidhen fukahatë nga e gjithë bota islame është "Akademia ndërkombëtare e Fikhut Islam" me qendër në Xhideh, në sesionet e së cilës jepen përgjigje të studiuar akademike për të gjitha temat bashkëkohore dhe në çdo sferë të jetës. Ky referim i ndihmon shumë hoxhallarët që t'i shikojnë çështjet e reja bashkëkohore të studiuar nga ana akademike dhe mbi të gjitha u heqë atyre përgjegjësinë për të dhënë fetva nisur nga dija e tyre personale.

Duke u nisur nga sa thamë më lart e

Profeti Muhamed a.s. thotë: "Kush i jep iftar një agjëruesi, ai do të marrë sa shpërblimi i tij pa u pakësuar agjë nga shpërblimi i agjëruesit." (Ahmedi)

**PAJTIMME ALLAHUN  
FALJENGA ALLAHU  
NJËJETËRE**

Për hajr :)  
muaji i baktuar i  
**RAMAZANIT**

ALLAHU THOTË:  
"THUAJ: "O ROBËRIT (KRIJESAT) E MI,  
QË I KENI BËRË KEQ VETES ME **GJYNAHE**,  
MOS E HUMBNI SHPRESËN NË MËSHIRËN E ALLAHUT!  
ALLAHU, ME SIGURI, I FAL TË GJITHA GJYNAHET.  
VËRTET, AI ËSHTË FALËSI I MADH DHE MËSHIRËPLOTI."  
KURAN, 39: 53.

**NEWBORN'RAMAZAN**

**MBLEDH ZEKATIN TUAJ**

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë  
Tel: 0672304520 / 0672538334 / 048320160  
BKT Banka Kombëtare Tregtare  
Nr. i llogarisë : 52416329

Për zekatin në lekë:  
IBAN: AL 43 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLB  
Llogaria në lekë:  
IBAN: AL 70 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLA  
Llogaria në Euro:  
IBAN: AL 37 2051 6703 4163 29CL OTCF EURO  
Llogaria në Dollarë:  
IBAN: AL 81 2051 6703 4163 29CL OTCF USDA

**Zekati**

## Fq 7 / Mësimi fetar islam në shkollat fillore dhe të mesme në luginën e Preshevës

Nga Valdet KAMBERI

## Fq 5 / Liria e besimit, shekullarizmi, komunikimi dhe kufizimet e lirive njerëzore

Nga Fitim ZEKTHI

ritheksojmë edhe njëherë se dhënia e fetvasë ka një përgjegjësi të madhe, ndaj dhe për këtë kërkohet nga vetë besimtarët muslimanë që të kontribuojnë në vendosjen e institucionit të fetvasë në shina të rregullta procedurale, si p.sh. duke e pyetur dhe kërkuar argumentin përkatës për çështjet e ndryshme, ose së paku të kërkohet nga hoxha se çfarë kanë thënë shumica e dijetarëve për çështjen që ai është i interesuar dhe cili është mendimi më saktë në rastin konkret dhe pse? Në këtë mënyrë pyetësi nuk imiton hoxhën si individ, por dijetarët dhe imamët e mëdhenj të umetit. Ndërsa për

çështjet e reja bashkëkohore besimtari duhet ta pyesë hoxhën se çfarë kanë thënë për të akademitë shkencore islame dhe cilat janë përfundimet e tyre akademike. Në këtë mënyrë besimtarët do të jenë më të sigurt shpirtërisht në marrjen e përgjigjeve dhe do kenë kohë dhe mundësi të përfitojnë më shumë nga dijet e ndryshme islame, dhe natyrisht do të dalin nga amullia dhe anarkia që mbizotëron sot në xhematet e myslimaneve për sa i përket marrjes së fetvave. Në të njëjtën kohë kjo gjë ndihmon dukshëm në shuarjen graduale të individualitetit në çështjen e dhënies së fetvave.

# Si vepron me pasurinë e fituar haram?

Në çdo kohë gjenden njerëz të cilët nuk i binden urdhërësve të Zotit dhe kryejnë atë që Ai ka ndaluar. Një nga këto ndalesa, që shpesh nuk respektohet, është edhe sigurimi i pasurisë me anë të mjeteve të ndaluara, siç është vjedhja, grabitja, mashtrimi, kamata, bixhozi, ryshfeti, korrupsioni, shfrytëzimi i padrejtë, shitja e mallrave të ndaluar... etj. Pasuria e fituar haram në këtë mënyrë përbën rrezik si për vetë personin ashtu edhe për shoqërinë njerëzore, ajo mbi gjithçka rrezikon të tërheq ndëshkimin e Zotit në këtë botë dhe në tjetrën. Ndodh që kjo pasuri të bjerë në duart e shtetit apo vetë personi të pendohet dhe kërkon të shpëtojë prej saj. Si vepron në këtë rast sipas ligjeve islame? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje kemi zgjedhur një studim akademik, autori i të cilit ka mbrojtur me të gradën shkecore të doktoratës në një nga universitetet e botës islame. Më poshtë do të paraqesim përfundimet në të cilat ai ka arritur nga ky studim, duke iu referuar për këtë librit të tij me titull: Dispozitat e pasurisë haram

Rregullat sesi përfitohet dhe vepron me të sipas të drejtës islame; Punuar nga: Dr. Abas Ahmed Muhamed el-Baz, nën mbikëqyrjen dhe kujdesin e Prof. Dr. Omer Sulejman el-Eshkar

Bot. Dar en-Nefais 1418 h/ 1998 e.s. Aman Jordani.

Autori i veprës në faqen 439 të librit të tij paraqet këto rezultate të studimit të tij duke thënë: Nga studimi i temës kam arritur në këto përfundime:

- Pasuri haram quhet çdo objekt me vlerë të cilën Islami ia ka ndaluar muslimanit ta posedojë atë. Kjo pasuri mund të jetë haram në vetvete (si pijet alkoolike, mishi i derrit etj. sh.p.) ose haram për shkaqe të jashtme. (si kamata, ryshfeti, etj. sh.p.)

- Pasuria haram në përgjithësi nuk quhet pronë (e ligjshme fetarisht, sh.p.) për muslimanin, sado qoftë sasia e saj pak apo shumë.

- Pasuria haram (që i përket dikujt tjetër, sh.p) nuk trashëgohet, sepse ajo vazhdon të konsiderohet në pronësi të pronarit të parë. (p.sh. një mall apo objekt i vjedhur: tokë, makinë etj. sh.p.)

- Pasuria e fituar me një kontratë të pavlefshme fetarisht (batil/fasid) nuk lejohet të merret, ajo duhet të largohet nga zotërimi.

- Pasuria e fituar nga një kontratë për të cilën nuk bihet dakord mes dijetarëve, nëse është e lejuar ose jo, nuk gjykohej si haram, nëse mospajtimi për të është i konsiderueshëm. Jo çdo gjë që beson një dijetar se ajo është haram ajo është e tillë.

- Pasuria haram, e fituar në kohën para se dikush të bëhej musliman, është hallall për të edhe pasi ai të jetë bërë musliman, ai nuk është i detyruar ta heq atë nga zotërimi i tij.

- Pasuria e humbur e dikujt është haram për atë që e gjen para se ai ta publikojë atë për të gjetur pronarin e saj, por është hallall për të pas publikimit, për aq kohë sa nuk

gjendet pronari i saj.

- Pasuria e fituar haram nga padija është hallall, nëse gjatë kohës kur ajo është fituar përfuturi i saj nuk e dinte se ajo është haram.

- Çdo pasuri që gjykohej nga feja si haram në vendet muslimane si p.sh: kamata, bixhozi... etj e tillë ajo konsiderohet edhe në çdo vend tjetër. Ky është opinionimi i saktë për këtë çështje.

- Fitimi që një musliman nxjerr, duke investuar pasurinë e tij në kamatë, në vendet jomuslimane, është i papastër dhe është haram të merret. (p.sh. interesi bankar, sh.p.)

- Nuk lejohen transaksionet me poseduesin e një malli haram ku si objekt i transaksionit është vetë malli haram.

- Lejohet transaksioni me poseduesin e pasurisë haram kur e ka atë të përzier me hallall, por kjo në vetvete është e papëlqyeshme.

- Lejohet pa asnjë problem transaksioni me muslimanin që nuk i dihet gjendja e pasurisë, nëse thjesht dyshohet se në pasurinë e tij ka haram.

- Lejohet transaksioni me një jomusliman për mallin që ai ka, sido që ai ta ketë fituar atë, hallall ose haram, nëse kjo marrëdhënie kryhet në përputhje me rregullat e fesë dhe dispozitat e shariatit.

- Qenia haram e pasurisë është një emërtim që bie si gjykim mbi atë që e merr atë dhe jo mbi vetë objektin. (p.sh. jo paraja në vetvete si para, por për shkak të mënyrës së fitimit të saj, sh.p.)

- Malli haram nuk lejohet që të eliminohet duke u djegur, prishur ose hedhur në det.

- Pasuria haram nuk është objekt përfitim për asnjë, përveç se të shpenzohet në drejtimet e lejuara nga shariat.

- Pasuria haram që nuk i dihet pronari shpenzohet për të mjerët, të varfrit, njerëzit në nevojë si dhe për objekte në interes publik të muslimanëve.

- Dhënia e pasurisë haram për shpenzime të përcaktuara fetarisht si bamirësia për të varfrit, nevojtarët dhe për objekte me përfitim publik për muslimanët, nuk quhet sadaka nga e cila fitohet shpërblim. Ky veprim është thjesht heqje e përgjegjësisë së gjynahut dhe pastrim i pasurisë së përzier me haram.

- Kthimi i pasurisë pronarit të ligjshëm, nëse ai njihet, apo shpërndarja e saj të varfërve dhe nevojtarëve, kur ai nuk njihet, është kusht për pranimin e pendimit për atë që është duke larguar prej tij pasurinë haram.

- Fakti që shteti ka në thesarin e tij pasuri haram nuk përbën pengesë për të punuar në të, sepse së pari kjo pasuri nuk është e përcaktuar se cila është dhe së dyti sepse njerëzit kanë nevojë për punë.

- Pasuria hallall, e shpenzuar për gjëra që janë gjynah, konsiderohet e dalë nga pronësia e pronarit e të saj të parë. Nëse ajo kthehet duhet të shkoj për bamirësi për të varfrit, nevojtarët dhe në objekte në interes të muslimanëve. (p.sh. paratë që humben në baste apo bixhoz, nëse ato rimerren, sh.p.)

- Disa nga hapësirat ku shpenzohet pasuria haram janë: ndërtimi i shkollave, hapja e rrugëve, ndërtimi i spitaleve ose klinikave mjekësore, dhënia studentëve të dijes... etj.

- Nuk lejohet që të ndërtohen xhami apo vende adhurimi me pasuri haram, sepse Allahu i Madhëruar është i Mirë dhe pranon vetëm të mirën.

- Lejohet për muslimanin të shpenzojë për vete dhe familjen e tij nga pasuria haram për aq kohë sa e ka të pamundur të sigurojë pasuri hallall.

- Lejohet marrja e borxhit nga borxhliu që konsumon pasuri haram, nëse kjo pasuri nuk i përket një pronari tjetër të caktuar. (p.sh. para të vjedhura, sh.p.)

- Haxhi i kryer me pasuri haram është i saktë dhe largon barrën e këtij detyrimi fetar, por si veprim është i shëmtuar dhe nuk ka shpërblim për të.

- Shlyerja e taksave me pasuri haram nuk lejohet, sepse kjo shpie në konsumimin e pasurisë haram që është e ndaluar. (për më shumë shiko fetvanë Nr. 48 sh.p.)

- Fitimi i nxjerrë nga investimi i pasurisë haram është haram, sepse ai është degëzim i kapitalit fillestar ndaj dhe nuk lejohet të përfitohet prej tij, djersa e të padrejtë në këtë rast nuk meriton të shpërblehet.

- Pastrimi i parave haram dhe parave të pista është i ndaluar nga ligjet fetare dhe ato shtetërore, sepse kjo pasuri është fituar me mjete të ndaluara dhe se i hap rrugën grupeve kriminale për të vënë nën kontroll pushtetin dhe organet e vendimmarrjes.

- Paratë haram që i nënshtrohen pastrimit duhet tu shkojnë të varfërve, nevojtarëve dhe për objekte me interes publik, pasi të jenë ngrirë dhe sekuestruar më parë nga shteti.

## Namazi i teravive

Namazi i teravive është sunet për burra dhe për gra. Fjala "teravi" është shumë e fjalës "teruihatun" e cila rrjedh nga fjala "rahatun", që do të thotë çlodhje, pushim. Imam el-Fejumi në "Misbahul Munir" dhe imam Ibn Mendhuri në "Lisanul arab" shpjegojnë se namazi i teravive është quajtur kështu ngaqë muslimanët e gjeneratës së parë kur falnin namazin e teravive pushonin pas çdo dy selamesh, pra pas çdo katër rekatësh. Buhariu dhe Muslimi transmetojnë se për vlerën e këtij namazi Profeti (alejhi salatu ue selam) ka thënë: "Kush ngrihet për t'u falur në Ramazan (teravitë) me besim të plotë dhe duke pritur shpërblim nga Allahu, atij do t'i falen gjynahet e mëparshme." Namazi i teravive falet pas namazit të jacisë dhe para namazit të vitrit, në xhami dhe me xhemat, por mund të falet edhe në shtëpi vetëm. Sunet është të falen tetë rekatë, duke dhënë selam pas çdo dy rekatësh. Aishja (radijallahu anha) thotë: "Profeti (alejhi salatu ue selam) nuk ka falur më shumë se njëmbëdhjetë rekatë në Ramazan dhe as jashtë Ramazanit." Transmeton Buhariu. Pra, tetë rekatë teravi dhe tre rekatë namaz vitër. Dijetarët e mëdhenj të umetit islam siç janë juristët e shkollave të njohura juridike islame dhe prijësit e tyre si imam Ebu Hanifa, imam Maliku, imam Shafiu, imam Ahmed ibn Hambeli, e të tjerë si imam Sufjan Theurij, imam Ibnul Mubarek etj., dhe dijetarët e mëdhenj të mëvonshëm, janë

të mendimit se namazi i teravive mund të falet edhe më shumë se tetë rekatë, pasi diçka e tillë ka qenë e njohur te tabiinët (pasuesit e sahabëve), të cilët i kanë falur teravitë dikush njëzet rekatë, dikush 36, dikush më shumë e dikush më pak. Imam el-Kemal Ibn Humami, njëri nga dijetarët më të njohur të medhhebit hanefi, thotë: "Sunet është që të falen tetë rekatë, ndërsa dymbëdhjetë rekatet e tjera (plotësimi i 20-shit) janë mustehab (vepër e pëlqyeshme)." Namazi i teravive mund të falet edhe nga gratë. Edhe pse namazi më i mirë për gruan është në shtëpinë e saj, siç ka ardhur në një hadith që e transmeton Ebu Daudi, kjo s'do të thotë se namazi i saj në xhami është i pavlefshëm, aq më tepër kur bëhet fjalë për namazin e teravive, i cili është një namaz i veçantë. Dalja e gruas nga shtëpia natën në xhami ka kushtet e veta. Ajo duhet të jetë e shoqëruar nga pjesëtarët e familjes së saj, të jetë e mbuluar, të mos zbukurohet për njerëzit e huaj si dhe të mos të parfumohet me erëra të mira. Është e pëlqyeshme që në namazin e teravive të merren edhe fëmijët që kanë mbushur moshën shtatë vjeç, që ta praktikojnë këtë namaz me xhemat në muajin e Ramazanit dhe që të marrin pjesë në mbarësinë dhe mirësinë që Allahu i Lartësuar zbret në këtë muaj madhështor. Allahu na bëftë prej adhuruesve të Tij dhe na pranofte adhurimet!

Përgatiti: Mustafa Tërniqi



Bordi botues:  
Justinian Topulli  
Genc Plumbi  
Mustafa Tërniqi

Redaktor përgjegjës:  
Roald A. Hysa

LIDHJA HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË

Unaza e Re, Rruga: Teodor Keko mbi Alfa Bank, Tirane-Shqiperi  
lidhjehoxhallareve@yahoo.com  
Tel & Fax: +355 (0)48320160  
<http://www.lidhjehoxhallareve.com>

# Dashuria për Zotin

Feja, sipas një përkufizim të përmbledhur, nuk është gjë tjetër veçse marrëdhënia që krijohet në mes Zotit dhe njeriut. Në thelb çdo marrëdhënie mes dy subjekteve ka ndjenjën, kjo ndjenjë mund të jetë vetëm dashuria, ose vetëm përfitimi, ose të dyja së bashku, ku dominon ose njëra ose tjetra. Edhe pse teorikisht do të duhej të thuhej se dashuria dhe përfitimi kanë një nivel ku ato janë të barabarta, në praktikë kjo gjë do të ishte e vështirë të provohej me ndjenjat njerëzore.

Për të kuptuar më lehtë sesi zhvillohet marrëdhënia e njeriut me Zotin, do të marrim si shembull mënyrën sesi zhvillohet marrëdhënia e njeriut me njeriun.

**Rasti i parë:** Një njeri mund ta dojë një njeri tjetër ashtu siç ai është dhe kërkon me ngulm e çdo kusht të fitojë dashurinë e tij, kjo sepse dashuria është një ndjenjë që kërkon shkëmbim të dyanshëm, kur ajo nuk finalizohet si e tillë dhe mbetet e njëanshme, atëherë kjo shkakton vuajtje. Në një situatë të tillë, kur një njeri është i mbushur me një dashuri të pakufishme për dikë tjetër, aq sa çdo qelizë e trupit të tij e dëshmon këtë gjë e kjo dashuri gjendet në çdo skutë të shpirtit të tij, ky njeri është i gatshëm për çdo lloj nënshtrimi, për çdo sakrificë, vetëm e vetëm për të arritur qëllimin e dashurisë së tij, që është të fitojë kënaqësinë dhe dashurinë e atij që ai do. Për të nuk ka asnjë rëndësi sakrificat që ai duhet të bëjë dhe koncesionet që duhet të japë, për të fituar me çdo kusht dashurinë e atij që ai do. Kjo dashuri natyrshëm shoqërohet me ndjenjën e frikës, të frikës dhe të shpresës, të frikës se mos i dashuri i zemrës nuk i përgjigjet kësaj dashurie dhe të shpresës se ai do t'ia arrijë qëllimit ta bëjë atë për vete, aq sa edhe ai ta dojë atë. Pikërisht kjo frikë dhe shpresë e mbajnë gjithmonë gjallë këtë dashuri, që asnjëherë ajo të mos venitet tek njeriu që do me gjithë shpirt dikë dhe e bëjnë atë kurdoherë këmbëngulës, deri në çastet e fundit të jetës. Kjo është një dashuri ku vihen re qartë elementët e admirimit sublim, e përgjërimit, nënshtrimit, frikës dhe shpresës, e thënë më shkurt ky është vetë adhurimi. Për këtë dhe Ibn Kajimi thekson se, thelbi i adhurimit ndaj Zotit është dashuria e pakufitë për Të. Nëse një dashuri e tillë shfaqet te krijesat për krijesat, atëherë ajo shndërrohet në atë që quhet *shirku i dashurisë*. Kjo është një nga format e idhujtarisë, ta duash krijesën ashtu siç duhet të duhet vetëm Zoti. Për këtë Allahu i Madhëruar thotë: **“E megjithatë, disa njerëz zgjedhin (për të adhuruar) në vend të Allahut (zota) të tjerë, (duke i konsideruar) si të barabartë me Të dhe**

**duke i dashur siç duhet Allahu. Por ata që besojnë, e duan shumë më tepër Allahun”** (el-Bekare: 165)

Një njeri që ka një dashuri të tillë gjendet në pozitën e atij që kërkon sa më shumë njohjen e atij që do, njohjen e çfarë i pëlqen të dashurit të tij dhe çfarë jo, çfarë mund ta bëjë atë për vete dhe çfarë jo, pra në këtë rast ai pret që, i dashuri i tij të jetë ai që i udhërrëfen atij rrugën për të fituar dashurinë e tij, në këtë rast ai nuk shpik dhe as nuk sajton, por vetëm kërkon të dijë deri edhe në detajet më imta aprovimin ose jo të atyre gjërave që ai bën, për të fituar dashurinë e të dashurit të tij. Një dashuri e tillë është një dashuri që kërkon, ndjek, pason bindet dhe nuk shpik. Pikërisht kjo është edhe udha që të shpie në fitimin e dashurisë së Zotit, Allahu thotë: **“Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t’ju dojë dhe t’ju falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë”.**” (Ali-Imran: 31)

**Rasti i dytë:** Kur një njeri e do një tjetër për aq sa e do ai atë. Ai i ofron dashuri atij që do, me kusht që i dashuri i tij t’i ofrojë po të njëjtën dashuri, pra kërkon respekt dhe dashuri reciproke të kushtëzuar. Nëse kjo nuk i afrohet, dashuria e tij për të -për shkak të zhgënjimit që njeriu pëson- do të venitet ose do të zhduket plotësisht. Një dashuri e tillë është në thelb një dashuri mes të barabartëve, një dashuri që kërkon të imponohet dhe pranon shumë pak ose aspak nënshtrime dhe koncesione. Një dashuri e tillë nuk është një dashuri e plotë nënshtrimi, frike dhe shprese dhe nuk kërkon me domosdo njohjen e gjithçkaje që i pëlqen të dashurit, pasi mjafton që ai e do dikë dhe nuk është kusht që ta di nëse gjithçka që ai ofron për këtë dashuri është e pranuar dhe e pëlqyer që më parë nga ai që ai do. Mjafton që dashuria dhe respekti që ofron ky njeri për dikë tjetër, ashtu siç ai e ndjen, të jetë plotësisht e mjaftueshme që tjetri ta pranojë atë dhe t’i përgjigjet po me të njëjtën dashuri.

Marrëdhënia e dashurisë mes Zotit dhe njeriut nuk mund të ngrihet mbi një bazë të tillë, sepse ajo në thelb është ngritur mbi ndjenjën e barazisë dhe jo të ndjekjes dhe nënshtrimit absolut. Është pikërisht kjo lloj dashurie që nëse lind tek njerëzit për Zotin, nuk shoqërohet me masën e duhur të frikës dhe shpresës dhe të ndjekjes, e që janë kushtet e pranimit të adhurimit në Islam dhe të fitimit të dashurisë dhe kënaqësisë së Zotit. Kjo lloj dashurie prodhon iluzionin e të qenit pranë Zotit edhe kur në fakt nuk je, prodhon një siguri imagjinare ndaj ndëshkimit nga Zoti dhe bindjen absurde se



njeriu është i pranuar dhe i dashur tek Zoti, sado gjynahqar apo mëkatar të jetë ai. Kjo lloj dashurie bëhet shkak edhe për prodhimin e risive në fe dhe mosvlerësimin të pozitës së skllavit apo të krijesës së nënshtruar, që njeriu ka ndaj Krijuesit. Një dashuri e tillë për Zotin është shfaqur te të krishterët dhe hebrenjtë, dhe këtë Allahu e tregon mjaft bukur kur thotë: **“Hebrenjtë dhe të krishterët thonë: “Ne jemi bijtë e Allahut dhe të dashurit e Tij”.** ky është shembull i një dashurie të mes të barabartëve që në realitet nuk janë të tillë, ndaj dhe Allahu zhvlerëson dhe tregon papranueshmërinë e kësaj dashurie duke thënë më pas: **“Thuaj: “Atëherë, përse Ai ju dënon për shkak të gjynaheve tuaja? Jo! Ju jeni njerëz nga ata që Ai ka krijuar. Ai fal kë të dojë dhe dënon kë të dojë.”** (el-Maide:18)

Shembulli sesi kjo dashuri i hap portën risive në fe, është ajeti që flet për murgërinë në mesin e të krishterëve:

**“Sa për murgërinë, Ne nuk ua urdhëruam atë, por ata e shpikën vetë për të arritur kënaqësinë e Allahut.”** (el-Hadid: 27)

Një fenomen i ngjashëm me këtë lloj dashurie shfaqet edhe tek një pjesë e sufive në Islam, tek të cilët në dallim me nocionet e Islamit për adhurimin, dashurinë e shohin si të vetmin motiv dhe shtytës së adhurimit, ndërkohë që frika nga ndëshkimi i Zotit dhe shpresa për të fituar shpërblimin e Tij tek disa prej tyre konsiderohet si shirk që përzien në mes interesin material të njeriut. I pari që pretendohet të ketë shprehur një qëndrim të tillë të panjohur më parë, është Rabiati Adivije nga Basra e Irakut (135 h.), të cilës i atribuohet dyshueshëm koncepti i adhurimit për hir të dashurisë dhe përjashtimi i frikës dhe shpresës si pjesë e këtij adhurimi! Koncepti

i dashurisë (arab. *hub*) më pas tek sufitë evoluon edhe më tej në *ashk* (arab. *ishk*) dhe bashkë me nocionin e *unitetin të qenies* (*uahteul uxhud*) ai fillon t’i ngjaj në përfundimet e tij gabimit të mësipërm të të krishterëve dhe çifutëve që e konsideronin veten e tyre si bij dhe të dashurit e Zotit, pra jo si krijesa tërësisht skllave dhe të ndara nga Krijuesi transcendent, por si pasqyrimet e brendshme të Qenies, të një Krijuesi immanent dhe transcendent njëkohësisht.

**Rasti i tretë** i marrëdhënies së një njeriu me njeriun, është marrëdhënia e përfitim-shkëmbimit. Këtu dashuria ose nuk ekziston fare ose është në nivelin minimal të mundshëm dhe është një dashuri nga cila pritet vetëm një përfitim, kryesisht ai material i kësaj bote. Këtë dashuri mund ta quajmë dashuri tregtare, dashuri më jep-të jap. Në të ekziston vetën fryma e të drejtave dhe detyrimeve reciproke sipërfaqësore, tamam si në një kontratë shkëmbimi mallrash. Në këtë lloj dashurie nuk gjen elementë të sinqeritetit, të frikës apo shpresës, për aq kohë sa ai që shet mendon se malli i tij vlen ndaj dhe për rrjedhim pala tjetër është e detyruar të përgjigjet.

Edhe kjo rast marrëdhëniesh, si në rastin e dytë, e bën njeriun të ndjehet i barabartë me tjetrin. Nëse vendoset një marrëdhënie e tillë e frohtë nga njeriu me Zotin është marrëdhënie mashtruese, ku në fakt njeriu vetëm mashtron vetveten dhe bie në pozitën e një hipokriti. Allahu i Madhëruar për këtë thotë: **“Ka disa njerëz që thonë: “Besojmë në Allahun dhe në Ditën e Gjykimit”, por në të vërtetë ata nuk janë besimtarë. Ata përpiqen të mashtrojnë Allahun dhe besimtarët, por në të vërtetë mashtrojnë vetëm vetveten, megjithëse nuk e ndiejnë.”** (el-Bekare: 8)

j.topulli

## Si bëhet shlyerja e agjërimit për ata që e kanë të pamundur të agjërojnë

**Pyetje:** Një person që është musliman dhe do të agjërojë, por në pamundësi të shëndetit të tije të keq pra (është i sëmure dhe merr ilaçe). Do të japë kompensim pra te ushqeje te varfër si e jap këtë kompensim ne lek apo ushqim? Sa? Dhe kur e jep? (për çdo ditë, në fillim, apo në fund)

**Përgjigje:** Kompensimi për shlyerjen e agjërimit jepet në ushqim, nga ata muslimanë që kanë sëmundje kronike, ose janë të thyer në moshë dhe nuk mund të agjërojnë. Nga

sahabi i nderuar Enes ibn Malik, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, përcillet se kur ai shkoi në moshë të thyer dhe e kishte të pamundur të agjëronte, grumbulloi tridhjetë të varfër në një ditë dhe u shtroi ushqim për të ngrënë. Këtë kompensim njeriu i interesuar mund ta japë vetë ose mund të ngarkoj dikë tjetër për ta bërë këtë gjë për të. Kompensimin mund ta japë për çdo ditë të Ramazanit, ose në fund të Ramazanit. Ai jepet në dy mënyra:

a) nga një vakt ushqim për aq ditë sa nuk ka

agjëruar. b) ose mund të japë ushqim të pagatuar (të paktën gjysme sa, e barabartë kjo me masën e dy grushteve, prej artikujve ushqimor si: oriz, fasule, etj., ose një grusht miell).

Kompensimi i agjërimit në pamundësi mund të jepet edhe në vlefte monetare, por me kusht që kjo vlefte të shkojë për ushqim. Kosto e këtij ushqimi ndryshon në varësi të mundësisë ekonomike dhe ushqimit që konsumon vetë personi që duhet të japë kompensimin e agjërimit. Sipas një llogaritje të përafërt në lekë, në kohën

që jetojmë, kjo shumë për ushqim të gatuar për Shqipërinë mund të shkojë së paku tek 250-300 lekë të reja, e mjaftueshme kjo për ushqimin një vakti të thjeshtë ngrënie për një njeri, kjo më pas shumëzohet për aq ditë për sa do të bëhet konpesimi. Nëse kjo shumë jepet për blerjen e një ushqimi të pagatuar do të ishte më mirë, sepse i bie një sasi më e madhe dhe në këtë rast është më me interes për njerëzit nevojtarë. Allahu e di më së miri!

Komisioni i Pyetje-Përgjigjeve pranë LSHH

# Klubi i Mundjes



Mundësit e Çeçenisë dhe Dagestanit garojnë si rusë. Por në kodra – madje dhe në palestër – Rusia është akoma armiku

Nga Simon Shuster/Kasavjurt

Adem Sajtiev, kampioni olimpik i mundjes në stilin e lirë, nuk reagon fare kur krismat e armëve dëgjojnë që jashtë, duke oshëtitur mbi muret e shtëpisë së familjes së tij në qytetin rus Kasavjurt. Duket sikur vijnë nga prona ngjitur, një truall i papunuar ku ai dhe vëllai i tij më i madh, Buvajsar, tre herë kampion olimpik, hapën një shkollë olimpike për mundje në Maj, tamam në kohë për të ndihmuar mundësit e boksierët lokalë për tu trajnuar për Lojërat Olimpikë të verës. Fytyra mjekroshe e Ademit, një shenjë e një myslimani sunit në këtë zonë të Ruisë, buzëqesh kur unë instinktivisht stepem nga zhurma e të shtënavë. “Relaksohu” thotë. “Me siguri dikush po gjuan thjesht për qef.”

Kjo nuk është shumë qetësuese në një zonë si Kasavjurt. I vendosur mu në qendër të Kaukazit të Veriut, një sipërfaqe malesh në jug të Ruisë që përfshin republikat e paqëndrueshme të Çeçenisë e Dagestanit, ky qytet prej 130.000 banorësh është një nga frontet më të panënshtruara në luftën e Ruisë kundër terrorizmit. Për dy dekada, sidomos gjatë dy luftërave çeçene të viteve 1990, kryengritësit e përdorën si vend pushimi e furnizimi.

Kohët e fundit at kanë filluar të shkojnë atje për të rekrutuar, që tregon se kultura mundëse e qytetit ka të bëjë me më tepër se me fitimin e trofejeve. Buvajsar, i cili i fitoi tre medaljet e tij Olimpikë të arit në kategorinë 74 kg, e përshkruan mundjen njësoj siç përshkurante Karl Marksi fenë – si “një mënyrë për të kontrolluar masat.” Ideja është që të shërbejë si një lloj vaksinimi ndaj ekstremizmit, ose të paktën si një hutim prej tij, duke u ofruar fëmijëve lokalë një mundësi për të dalë nga getoja pa “dalë në pyll”, thotë Buvajsar, duke përdorur slang-un rus që nënkupton bashkimin me kryengritësit.

Kjo është zgjedhja që sundimi rus u ofron burrave të Çeçenisë: ose asimilohu ose rreziko persekutimin si simpatizues i terroristëve. Kjo i detyron ata në një lloj loje të pamundur balancimi midis përshtatshmërisë dhe krenarisë, dhe vëllezërit Sajtiev, si shembuj modelë, ecin mbi këtë fill të tendosur në dy mënyra krejt të ndryshme. Me moshë dhe sukses, Buvajsar, 37 vjeç, është dorëzuar ndaj integritetit rus, ndërsa Ademi, 34 vjeç, të paktën me fjalë, vazhdon të rezistojë. Përgjatë rrugës, ata të dy kanë frymëzuar një gjeneratë çeçenësh për ta kanalizuar agresivitetin e tyre drejt sportit, duke u bërë aktorë në një formë të fuqisë së butë që deri tani i ka shërbyer mirë Ruisë. Çdo vit, Rusia shpenzon më pak se një milion dollarë për të mbështetur shkollën e

mundjes në Kasavjurt – shumë më pak se çdo duhej për të ndërtuar universitetet apo për të siguruar punët e paguara mirë për të cilat ky qytet me të vërtetë ka nevojë.

Për numrin e medaljeve të Ruisë, rezultati ka qenë i mahnitshëm. Në katër lojërat e fundit Olimpikë, mundësit nga Kasavjurt kanë sjellë në shtëpi 8 medalje ari në stilin e mundjes së lirë, bashkë me të paktën 12 medalje nga kampionatet botërore dhe shumë e shumë trofej nga turnetë kombëtare e Evropjanë.

Mundja u zhvillua shumë në këtë cep të Kaukazit pasi Sovietikët e dalluan shkathtësinë dhe forcën e burrave lokalë në vitet '60 dhe dërguan disa nga mundësit më të mirë sovjetikë në këtë rajon për të krijuar shkolla trajnimi. Rezultati ka qenë një linjë e fuqishme mundësish medalistë nga kjo zonë. Në Lojërat e Londrës, të paktën dy mundës nga Kasavjurt do garojnë për të afirmuar nofkën e qytetit të tyre si: Furrnalta e Kampionëve, e cila është e shkarravitur në reklama me shkrim jeshil pranë pazarit kryesor, duke treguar Buvajsarin në mes të një mbërthimi.

## PADRONËT E RINJ

Vëllezërit Sajtiev, të cilët kanë 13 gjenerata në Kasavjurt, kanë shërbyer për më shumë se një dekadë si djemtë modelë të idesë së paqësimit nëpërmjet sportit. Ata u rekrutuan në këtë rol menjëherë pas luftës së dytë Çeçene, e cila përfundoi në 2000-shin me pushtimin nga Rusia të republikës separatiste. (OKB-ja e quajti kryeqytetin e Çeçenisë, Groznin, “qyteti më i shkatërruar në tokë.” Më shumë se 500.000 veta vdiqën, kryesisht civilë.) Disa javë më vonë, ndërsa tanket ruse akoma pushtonin rajonin, presidenti i sapozgjedhur, Vladimir Putin, zgjodhi një myfti ish-rebel të quajtur Ahmed Kadirov për të drejtuar Çeçeninë, duke i dhënë atij detyrën për të kontrolluar separatistët me çdo mënyrë të mundshme. Kadirov, si një udhëheqës shpirtëror i respektuar, ishte një nga burrat e paktë të cilët mund ti bënin çeçenët ta pranonin disfatën e të vazhdonin jetën.

Pas caktimit të tij, Kadirov thirri një takim të sportistëve lokalë, disa nga të cilët sapo ishin kthyer nga Lojërat Olimpikë të Sidnejit. Djali i tij, Ramzan Kadirov, i cili do merrte drejtimin e Çeçenisë pas vrasjes me atentat të babait të tij nga separatistët më 2004-ën, shkoi në Kasavjurt për të ftuar vëllezërit Sajtiev. Ata vozitën të nesërmen në mëngjes për në Gudermes, një qytet që po shërbente si qendra e komandës për forcat ruse.

Ahmed Kadirov i priti ata me dhurata të shtrenjta. Buvajsar mori një televizor, ndërsa Ademi, i cili sapo ishte kthyer nga Sidnej me një medalje ari në kategorinë 85 kg, mori çelsat e një makine të re. Dhuratat ishin simbole të rolit të Sajtievëve në elitën e re çeçene që po formohej rreth Kadirovit. “Kjo ishte pjesë

e politikës së tij sociale,” thotë Buvajsar. “Socializim nëpërmjet sportit.” Si çeçenë dhe kampionë olimpikë, vëllezërvë iu kërkua ta aplikonin këtë politikë dhe të ndihmonin rusët që sapo kishin pushtuar atdheun e tyre.

Ky nuk ishte një propozim i lehtë. Duke u rritur, Ademi dhe Buvajsar kishin mësuar të mbanin mend krimet e kryera nga sovjetikët. “Memorja e tyre më e gjallë kolektive”, siç e përshkruan Buvajsar, ishte deportimi në masë i 1944-ës, kur Jozef Stalini akuzoi gjithë çeçenët si bashkëpunëtorë të nazistëve dhe shpërnguli gati gjysëm milion prej tyre në Siberi dhe në stepat e Kazakistanit, me mijëra milje larg shtëpive të tyre. Mes gati 130.000 çeçenëve që vdiqën gjatë deportimit ishte dhe gjyshti nga nëna i vëllezërvë Sajtiev. Deri në kohën kur familja u lejua të kthehet në shtëpi, më 1956-ën, nëna e tyre kishte humbur 6 nga 10 vëllezërit e motrat e saj. “Kjo është ajo me të cilën ne jemi rritur,” thotë Buvajsar. “Këto memorje, gjithë ajo dhimbje – e bën një çeçen ta humbë durimin për punë sekondash.”

Si djalë i ri, Buvajsar e kanalizoi zemërimin e tij drejt sportit. Në 1996-ën, kur ai ishte 21 vjeç, garoi në lojërat olimpikë të Atlantës. Ishte një garë e dhimbshme, jo dhe aq për shkak të brutalitetit të ndeshjeve, por sepse ai po përfaqësonte ekipin rus ndërsa çeçenët po zmbropsnin ushtrinë ruse. “Gjithkush që njihja po luftonte,” thotë ai. “Dhe ja ku isha unë, si një i marrë në rrobat e ngushta të mundjes, sepse e dija që pushka ime e vetme nuk do i shtonte shumë betejës.”

Ai ishte tepër i vetëdijshëm që në qytetin e tij, shokët dhe familjarët e tij po strehoeshin në bodrume nga bombat ruse, duke kthyer antenat në televizorët e tyre portativë për të kapur një shikim të tijin në tapetin e mundjes. Kështu, pasi e fitoi ndeshjen e fundit, Buvajsar e dedikoi fitoren e tij live në televizionin rus ndaj vuajtjeve të popullit çeçen. “Deri atëherë Rusia më ishte shfaqur vetëm përmes tytës së tankut,” thotë ai. “Vetëm kaq kisha parë nga ajo.”

Për shumicën e çeçenëve, Buvajsar ishte një hero. Po, ai kishte garuar nën flamurin e pushtuesve, por ai ishte çeçeni i parë në histori që fitonte medalje ari në lojërat Olimpikë – një ngritje morali shumë e madhe. Një muaj pas fitores së tij Olimpikë, çeçenët i mposhtën forcat ruse dhe, me firmosjen e një marrëveshje paqeje, fituan pavarësinë e tyre de facto për të parën herë në një shekull e gjysëm.

Fitorja do ishte e jetë-shkurtër. Tre vite më pas, konflikti u rindez nën komandën e Putin, i cili në atë kohë ishte kryeministri i Ruisë, dhe forcat pushtuese kësaj here nuk ishin batalionet e paorganizuara që pati dërguar Presidenti Boris Jelstin në 1996-ën. Putini mobilizoi krejt fuqinë e ushtrisë ruse kundër rebelëve, të cilët shumë shpejt e kuptuan se rezistenca e mëtejshme ishte e kotë. Mijëra prej tyre, duke përfshirë klanin e Kadirovëve, bënë paqe me Moskën. Separatistët e mbetur dolën jashtë shtetit ose u fshehën në male, ku ata filluan një fushatë kundër rusëve që vazhdon deri sot. Të frymëzuar nga një formë puritane e Islamit Sunit të quajtur Selefizëm, liderët e kryengritjes kërkojnë themelimin e një kalifati në Kaukaz nën Sheriatin.

Përgjigja ruse ndaj kryengritjes është e gdhendur në pamjen e Kasavjurtit. Përtej rrugës nga prona e Sjtievëve, në rrugën Sulltanova, qëndron gërmadha e djegur e një shtëpie ku forcat ruse kohët e fundit rrethuan

një grup të dyshuar si kryengritës. Arteria e rëndë u soll në terren për të bombarduar shtëpinë, duke vrarë të gjithë ata që ishin brenda. Këto operacione speciale ndodhin çdo javë në rajon, duke vazhduar një konflikt i cili mori 285 jetë vetëm tre muajt e parë të këtij viti, sipas një numërimi të kryer nga agjencia e pavarur e lajmeve Kavkaz Uzel.

## DY RRUGË

Për djemtë e rinj lokalë, ka vetëm dy rrugë jashtë nga ky realitet. Mundësit e talentuar mund ta gjejnë rrugën drejt elitës ruse nëpërmjet sportit, një rrugë më së miri e ilustruar nga Buvajsar, i cili do ndihmojë në trajnimin e ekipit rus të mundjes në Londër. Ai e kalon shumicën e kohës këto ditë në Moskë, duke u trajnuar dhe relaksuar në një kompleks në pronësi të Ministrisë së Emergjencave në qendër të qytetit. Ajo ka banjo me avull, fushë futbollit, palestra luksoze, një sallë ngrënjeje, dhe një flotë me Mercedesat për transportin e anëtarëve. Duke ndejtur atje një mbrëmje pas darke, Buvajsar ishte dorëzuar ndaj faktit se Rusia është bërë atdheu i tij. “Nuk mund ta detyrosh një çeçen ta dojë Rusinë derisa ai ta mësojë atë dashuri vetë,” thotë ai. “Dhe unë mundohem ta mësoj veten ta dua atë.”

Pashmangshmërisht, roli i tij si ambasador i sportit rus e ka tërhequr atë në politikë. Këtë vit, Buvajsar shërbeu si një nga “fytyrat e besueshme”, ose përfaqësues të fushatës, për Putinin gjatë garës presidenciale, e cila i dha Putinit një mandat tjetër në detyrë.

Por Ademi, i cili është shumë më tepër fetar, ka zgjedhur një rrugë tjetër. “Ai e ndan kohën e tij më trash – palestra, xhamia, dhe shtëpia e familjes së tij,” thotë Salim Nutsalkhanov, trajneri kryesor i shkollës së mundjes së Sajtievëve. Akoma beqar, Ademi e sheh fenë si qëllimi i tij – shumë më tepër se sporti, të cilin ai e lidh me krenarinë e cekët. Përgjatë viteve, besimi i tij e ka tejkaluar ambicjen e tij sportive, dhe kur ai dështoi për shumë pak nga kualifikimi për në Londër, ai nuk dukej fort i mërzitur. “Ka gjëra shumë më të rëndësishme në jetë,” thotë ai.

Për shkak të besnikërisë dhe respektit ndaj vëllait të tij, Ademi ka rënë dakort të ndihmojë me menaxhimin e shkollës, por ai shumë rrallë shkon me Buvajsarin në Moskë. Dy herë në ditë ai shkon me nënën e tij për tu kujdesur për lopët e familjes, dhe ndërsa kafshët pëllisnin në stallën e tyre një mbrëmje Qershori, ai fliste për Islamin si e vetmja mbrojtje ndaj influencës së huaj të filmave rusë, alkoolit, dhe laicizmit. “Imazhet e Evropjanëve që ne shohim në filma nuk janë të pranueshme për një mysliman. Në asnjë mënyrë,” tha ai. “Nëse një mysliman e humbet fenë e tij, ai humbet çdo kuptim në jetën e tij. Prandaj lufta vazhdon.”

Nuk është një luftë për tokë a për burime resursesh por një luftë për identitet, sugjeron Ademi. Dhe nëse qëllimi i rusëve ishte të përdornin sportin si një mjet asimilimi, duhet të kishin zgjedhur një strategji më të mirë. Nxënësit në shkollën e mundjes së Sajtievëve, disa vetëm 9 vjeç, flasin çeçenisht me njëri tjetrin, dhe shumica e tyre ndjekin medresetë e Kasavjurtit, të cilat tani janë më të numërta se palestret. Dy herë në ditë, disa dyzina djemsh vijnë tek shkolla e Sajtievëve për tu trajnuar me kampjonët që mblidhen aty, duke ngritur peshat, bërë prova ndeshjeje, dhe duke planifikuar fitoret e tyre në lojëra Olimpikë të ardhshme. Asnjë nga ta nuk duket se i vë re zhurmat e të shtënavë që vijnë nga dritaret herë pas here. Por kur thirrja për në lutje kumbon nga minaret, ata ndalojnë trajnimin e tyre dhe me devotshmëri kthehen nga Meka.

Marrë nga Time Magazine  
Përktheu A.T

# Liria e besimit, shekullarizmi, komunikimi dhe kufizimet e lirive njerëzore

Nga Fitim ZEKTHI

Epoka në të cilën sot gjendet shoqëria njerëzore është një botë më së shumti e përkufizuar ose të paktën e kuptuar nga mënyra se si e paraqet atë televizioni, interneti dhe në tërësi mjetet e komunikimit. Arsyet pse ka marrë këtë pushtet televizioni apo mediat janë të shumta, por paralelisht me këtë fuqizim vihet re një fuqizim i rolit të shtetit, një rritje e shtetit dhe kufizimi i lirive të njeriut nga ana tjetër. Shteti sot në shumicën e vendeve të Perëndimit është shumë më i madh se sa 30 apo 40 vite më parë. Jo vetëm pesha e tij në ekonomi, por edhe ndikimi i tij në liritë njerëzore është më e madhe. Shteti sot ka nisur të shpërndajë të drejta, të krijojë të drejta siç janë ato të aksionit afirmativ, apo ato të lëvizjes gender apo të lëvizjes gay. Shteti sot ka marrë fuqinë në mjaft raste të tregojë se çfarë është martesë, se çfarë është shkolla, se si duhet të jetë dhe se çfarë duhet të mësohet në shkolla. Këto nuk janë të vërteta abstrakte, por këto janë disa prej shqetësimeve reale të shoqërive. Shumë studiues mendojnë se një prej arsyeve të krizës së madhe financiare ka të bëjë me këtë rol të rritur të shtetit. Në pamje të parë duket se kemi të bëjmë me një kontradiktë: fuqizimi i medias dhe i televizionit duhet të çonte në një shkallë më të madhe të Demokracisë dhe për rrjedhojë në një shkallë më të madhe të lirisë. Në fakt kjo nuk ka ndodhur dhe shkaku themelor është se media dhe televizioni janë shndërruar në elementë përbërës të makinerisë së madhe sociale që funksionon sipas rregullave të shoqërisë së konsumit. Duke qenë kështu ka një zgjerim të hapësirës së sekularizmit, ka një pushtet në rritje të tij dhe ajo që detyrohet të paguajë është feja, janë liritë fetare dhe ato të besimit. Në një farë mënyre edhe termat, konceptet dhe fjalët nisin të marrin ngjyrat e kësaj epoke dhe rreken të përcjellin atë që ajo përfaqëson. Në fakt kështu ka ndodhur gjithnjë, por sot kjo është shumëfishuar për shkak të rolit të medias dhe të televizionit në veçanti. Shekullarizmi, bota shekulare ka të sajën paradigmen e pushtetit, të fuqisë në të cilën domini dhe kontrolli janë vlera të brendshme. Për këtë botë efektiviteti është një kriter themelor. Shprehja më bazike e gjithë kësaj bote thotë Loui Safi, një studiues amerikan gjendet tek Makiaveli: “Qëllimi justifikon mjetin”. Kjo është një shprehje që shërben si parim udhërrëfyes në botën shekulare. Shën Agustini shkroi mbi bashkëjetesën e trazuar të shekullares dhe religjiozes në veprën e tij “Qyteti i Zotit”. Ky studiues i madh dhe një nga doktorët e kishës apo të Krishterimit siç quhet, tha se është e vështirë dhe madje e pamundur që këto dy botë të ndërvepronin apo të bashkëjetonin me njëra-tjetrën. Kohë më vonë, në Medine, myslimanët i treguan botës se është e mundur që vlerat morale të bëhen kriter i gjykimet politik. Në atë kohë, në Medine për herë të parë politika nuk gjykoj mbi paradigmen e fuqisë dhe të dominimit. Për herë të parë politika u bazua mbi vlerat morale dhe u udhëhoq vetëm nga ato. Në veprën e tij madhore “Historia e Filozofisë” Hegeli pranon se uniteti mes shekullares dhe spirituales zuri fill në shoqërinë myslimane shumë më herët sesa në atë të krishterë. Bota e krishterë, edhe ajo arriti të krijojë një bashkëjetesë të shekullares me spiritualen dhe arriti që vlerat morale të kenë ndikim, peshë por edhe rol në politikën e vendit. Megjithatë zgjerimi i hapësirës shekulare ka

vijuar pandalur të paktën që prej dy shekujsh dhe sot jemi në një pikë ku shoqëritë moderne janë më së shumti rezultat i rishtrukturveve sistematike në përshtatje me vlera morale që përkufizojnë jetën moderne. Këtë proces Max Weber, një prej sociologëve më të njohur të shekullit të kaluar e quan racionalizim. Weberi megjithëse e admironte këtë proces vuri re se po shfaqej gjithnjë e më shumë një prirje për ta tkurrur hapësirën e lirive individuale, që për pasojë shkaktonte humbjen progresive të lirisë. Kjo është në një farë mënyre, sipas këtij këndvështrimi pa dyshim të thjeshtuar, korniza në të cilën shekullarizmi dhe religjiozja janë të detyruara të ndërveprojnë sot. Në këtë kornizë zhvillon jetën e tij edhe komunikimi, në këtë kornizë gjuha, fjalët dhe imazhi përcjellin ide, pikëpamje, formësojnë opinion dhe qëndrime. Në vitin 2005 revista Time, kishte në kopertinën e saj një pikturë të Monalizës, të mbuluar me shamë islame. Kjo ishte gjetja e editorëve për të treguar se si perceptohet gruaja në Islam. Më shumë se kaq me këtë kopertinë u tregojë lexuesve, se si Islami e gjykon artin perëndimor dhe se si Islami mund të rrezikojë mënyrën e tyre të jetesës. Padyshim që është një këndvështrim shekullar, është një këndvështrim i shekullares, që nuk kujdeset për besimin dhe ndërjegjen e myslimanëve. Në anën tjetër kjo kopertinë nuk ka në fokus vetëm Islamin, por edhe fetë e tjera, sepse në thelb është një provokim ndaj besimit dhe lirisë së besimit. Dy vjet më parë kur në Zvicër u miratua nëpërmjet një referendumi ndalimi i ndërtimit të minareve, Ian Buruma një profesor në Oksford shkroi se zvicëranët votuan nisur nga ajo që iu ka ofruar televizioni. Ian Buruma shkroi në Nju Jork Times se në Zvicër janë gjithsej katër minare dhe se që të gjitha ato ndodhen në periferi të qyteteve dhe askush nga qytetarët e Bernës, Bazelit, Gjenevës apo Zyrihut nuk kishte parë ndonjë minare. Gjithashtu, tha Buruma, myslimanët me mjekër as që dalin nëpër qendrat e qyteteve dhe kështu që perceptimi i vetëm i tyre ishte ai i televizionit. Arsyeya pse ata votuan kundër minareve ishte televizioni. Të njëjtën gjë ka bërë televizioni edhe me Krishterimin, ku në shumë media është në fokus gjithçka ndodh në kisha apo dioqeza dhe ku sjellja e dobët e një prifti përdoret për të etiketuar si të tillë, problematike të gjithë kishën. Karikatura me priftërinj pranë fëmijëve, apo priftërinj që joshin vajza janë botuar në shumë media. Bill O'Reilli, një gazetar i famshëm amerikan e quan sulmin në shkallë të gjerë nëpërmjet gjuhës dhe etiketimit të medias ndaj kishës, si një sulm që vjen nga shekullarizmi. Shekullaristët, thotë Bill O'Reilli, kanë një problem bazik me religjionin, ata kanë frikë se mos vihet në diskutim morali i tyre personal. Siç e thamë më sipër në thelb të shekullarizmit qëndron paradigma e pushtetit dhe e forcës, dhe padyshim e efektivitetit. E moralshme është e efektshmja. Për herë të parë në historinë e mendimit njerëzor po shfaqen studiues që ia kushtojnë punën e tyre përhapjes së ateizmit. Këta të quajtur evangelistë ateistë si Sam Harris, Richard Dawkins apo Cris Hitchens shkruajnë mbi Zotin, si një krijesë të mendjes së njeriut, si një të krijesë të keqe që prodhon luftëra etj. Ata, madje, kanë dalë edhe me pankarta në rrugë ku thonë se Zoti nuk ekziston dhe janë përpjekur të organizojnë manifestime të ateistëve. Hapësira shekulare ka tentuar gjithnjë të rritet, ka tentuar ta shtyjë

religjionin në margjinë, ta zhvendosë nga jeta publike. Media por edhe i tërë mendimi liberal shekullarist ka krijuar klishe të tij, si: i krishterë i moderuar, i krishterë konservator, islam radikal, islam i moderuar etj. etj. Këto klishe dhe shekullarizmi kanë zhvilluar dhe zhvillojnë jetën e tyre edhe në Shqipëri. Tërë thelbi i tyre synon në ngushtimin e lirive fetare, në diktimin në mjaft raste prej shtetit të kufijve të besimit. Dua të ndalem në një rast të fundit që ka ndodhur në Shqipëri, rast që duket se simbolizon plotësisht përmasën e madhe të mos-respektit për fenë dhe liritë.

Shqipëria është një vend që ka shumë më tepër dobësi se vendet e tjera, sidomos ato të Perëndimit pasi ka jetuar mbi 40 vjet në një regjim të deklaruar ateist dhe si i vetmi vend ateist në botë. Në Shqipëri shekullarizmi ka rrënjë shumë të forta që i burojnë nga komunizmi.

Shembulli ynë është ai i një gjyqtari në Tiranë, që ka vendosur të mos lejojë të hyjë në një xhami imamin e saj Lulzim Plloçi. Gjyqtari thotë se “Lulzim Plloçi nuk lejohet të hyjë në xhaminë tek Medreseja, por mund t'i kryejë ritet fetare në një prej xhamive të tjera, nga të cilat Tirana ka plot”. Ka disa kohë që në media është raportuar, se Komuniteti Mysliman ka larguar nga Xhamia e Medresesë imamin Plloçi dhe ka emëruar atje dikë tjetër. Besimtarët nuk pranojnë imamin e ri që u ka çuar Komuniteti dhe gjatë kohës së faljeve i kërkojnë ish-imamin Plloçi t'i drejtojë ai. Komuniteti Mysliman e ka kallëzuar në polici ish-imamin. Ky është thirrur në polici, madje disa herë, nga zyra e Antiterrorit, e cila i ka kërkuar që të largohet në një kohë që ish-imami nuk e ka penguar imamin e emëruar rishtas. Besimtarët nuk e pranojnë imamin e ri t'i drejtojë ai në ritet fetare. Policia pa vendim gjykatë thërret dikë, një figurë të fesë, dhe i kërkon që të largohet nga drejtimi i besimtarëve, – sipas imamin, – edhe duke e fyer gjatë bisedave apo treguar se çfarë të veshë dhe çfarë jo. Pa u zgjatur tashmë ka ardhur edhe vendimi i gjykatës. Ajo e ndalon imamin të shkojë në xhami. Gjyqtari ka marrë atributet e parlamentit dhe ka shkruar një ligj të ri, në fakt një paragraf të ri të kushtetutës së vendit: -atë të lirisë së besimit dhe të shprehjes së tij. Gjithashtu gjyqtari, duke u shndërruar në parlament ka rrëzuar njohjen që Shqipëria i ka bërë Kartës së të Drejtave të Njeriut. Veç kësaj gjyqtari ka vendosur se cili është roli i shtetit në rregullimin e çështjeve të besimit. Ai ka përkufizuar kështu edhe se çfarë është laiciteti ose ekziston ai apo jo. Zgjedhja e imamin në një xhami, ose zgjedhja e njeriut që do t'u prijë besimtarëve në kryerjen e riteve fetare është një çështje shumë e rëndësishme në besimin islam. Imami dhe besimtarët gjatë riteve funksionojnë si një trup. Që prej vitit 1944 e deri në vitin në vitin 1967 shteti komunist i asaj kohe e pa fenë si armik dhe në kisha e xhami ajri i rëndë i frymës së tij largoi imamë, priftërinj, meshtarë, dhjakë e çfarëdo lloj shërbyesi tjetër, dhe emëroi të tjerë. Ishte shteti komunist kreu i doktrinës dhe kreu i institucioneve fetare. Në atë kohë shteti komunist madje edhe kërkoi ta ndante kishën katolike nga Vatikani, të themelonte një kishë katolike shqiptare. Kjo frymë vijon dhe u shfaq në vendimin e gjyqtarit, që urdhëroi moslejimin e imamin të hyjë në xhami. Mbi imamin nuk ka asnjë akuzë për dhunë, nuk ka akuzë penale për asgjë, madje Komuniteti Mysliman e ka në dispozicion si “kuadër”, siç e quan ai me gjuhën e vet.

Gjykatat Shqiptare në tërësi ende nuk e kuptojnë, se çfarë janë liritë fetare edhe vuajnë të menduarit me partishmërinë proletare të njeriut të ri. Liritë fetare janë liri dhe të drejta themelore dhe janë të shenjta për çdo vend laik. Demokracia liberale i mbron ato me shumë forcë dhe ato mbizotërojnë mbi shumëçka. Rreth dy vite më parë, një gjykatë në Nju Xhersi, SHBA thirri për dëshmitar një myfti gjatë një çështjeje ku diskutohet grindja mes dy bashkëshortëve myslimanë. Gjykatë duke iu referuar Amendamentit të parë të Kushtetutës Amerikane për lirinë e shprehjes dhe atë të besimit, mori vendimin duke marrë parasysh se çfarë thoshte besimi islam mbi atë çështje. Gjyqtari Mark Martin i Gjykatës Supreme të Karolinës së Veriut refuzoi të dënojë Talaag Elbayomy, një i ri mysliman që kishte rrahur një ateist, Ernie Perce, teksa ky po ecte në rrugë i veshur si një zombi i profetit Muhamed. Gjyqtari tha se Talaag Elbayomy ishte i detyruar ta bënte këtë, për shkak të besimit të tij dhe se Ernie Perce nuk duhet të provokojë dhe fyejë fenë e askujt pavarësisht se është ateist. Ky nuk është një shembull për të thënë se i padituri bëri mirë që qëlloi, por për të thënë se gjykatat e quajnë aq të shenjta lirinë fetare, sa ajo mbizotëron mbi shumëçka, përndryshe gjyqtari do ta dënonte.

Kushtetuta jonë parashikon po atë që parashikon kushtetuta e SHBA-së për liritë fetare, siç në fakt bëjnë edhe Karta e të Drejtave të Njeriut, por edhe kushtetutat e të gjitha vendeve demokratike. Në Gjykatën e Tiranës veprohet sikur të jemi në Republikën e 11 janarit të vitit 1945. Gjyqtari nuk do t'ia dijë se çfarë është një besimtar, çfarë është liria fetare dhe çfarë është një imam, prift apo shërbestar tjetër. Ai e mendon fenë si një gjë që e di shteti. Veç kësaj gjykatë në Shqipëri vendos nëse mund të hysh ose jo në xhami apo kishë. Kjo është e tmerrshme. Tani gjykatë mund të vendosë edhe nëse mund të mbash agjërim apo të ngjyrosësh vezët për pashkë. Fakti që Komuniteti Mysliman bën marrëzira dhe heq e vë imamë sipas “tablosë sinoptike” që i shfaqet apo sipas mënyrës që ai e sheh këtë, nuk është argument për gjykatën. Për gjykatën argument është kushtetuta, konventat e të drejtave të njeriut dhe ligji. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë ka rreth njëzet vjet që nuk e heq drejtuesin e një kishë në Elbasan, At Nikolla Markun. At Nikolla Marku mendon se kisha që ai drejton është kisha e vërtetë autoqefale dhe besimtarët e kësaj kishë ndjekin atë. Ai dhe besimtarët nuk ndjekin atë që i thotë kisha ortodokse autoqefale shqiptare që drejtohet nga hirësia e tij Janullatos, përkundrazi i kritikon ata për të shitur, për devijim, të pafe etj. etj. Mos duhet gjykatë e Tiranës të nxjerrë një urdhër që At Nikolla Marku, një shërbestar i dashur dhe shumë i respektuar në Elbasan të largohet dhe të mos futet në kishë si imami Lulzim Plloçi?! Do ishte marrëzi, do ishte diktim i shtetit se kë duhet të kenë besimtarët për drejtues të grigjës së tyre.

Nuk ka gjyqtar në botë sot të ndalojë hyrjen e një njeriu, e jo më të një kleriku, në kishë apo xhami e sinagogë, nuk ka gjykatë sot t'i tregojë besimtarit apo kujdto se ku mund të zhvillojë ritet fetare. Në Shqipëri kjo gjë mund të ndodhe me sa duket pasi sekularizmi, sipas paradigmes së pushtetit, mund të tregojë ai se çfarë është besimi dhe liritë fetare.

\*Ky shkrim është përmbledhje e një kumtese të mbajtur nga autori në seminarin e zhvilluar nga LSHH me temë “Gjetja e rrugëve të komunikimit me shoqërinë e sotme”, Tiranë qershor 2012.

# Agjërimi i Ramazanit

## Rregulla dhe Dispozita

Përgatitën: Mustafa TËRNIQI  
dhe Ervin QYLAFKU



### DISA DOBI TË AGJËRIMIT

Agjërimi është një adhurim i pasur me dobi shpirtërore, sociale dhe mjekësore. Nga dobitë shpirtërore mund të përmendim: agjërimi e forcon më shumë besimtarin në sinqeritetin e tij ndaj Allahut, e bën atë më të durueshëm nga uria dhe etja dhe kjo gjë e forcon atë më shumë për sprovat e jetës. Agjërimi e bën besimtarin të mendojë më shumë praktikisht për njerëzit e varfër, të cilën në shumë raste kanë uri dhe i merr etja. Agjërimi e largon njeriun nga mëkatet dhe në të njëjtën kohë e nxit besimtarin të punojë brenda këtij adhurimi e të veprojë punë të mira. Ai e nxit besimtarin të ndihet më afër me besimtarët e tjerë. Agjërimi e pastron besimtarin nga veset e liga.

### NATA E KADRIT DHE ARGUMENTET QË FLASIN PËR TË

Nata e Kadrit është nata më e mirë e gjithë vitit. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Fisnik: "Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj." [El Kadër: 8] Pra, vepra e mirë në këtë natë, për shembull namazi, leximi i Kur'anit, përmendja e Zotit, është më e mirë se vepra e një mijë muajve.

### KËRKIMI I NATËS SË KADRIT

Është e pëlqyeshme që të kërkohet kjo natë në netët teke të dhjetëditëshit të fundit të muajit Ramazan. Transmetohet se Profeti (alejhi selam) e ka kërkuar këtë natë në dhjetëditëshin e fundit të këtij muaji. Kur hynte fundi i muajit, Profeti (alejhi selam) i përkushohej Allahut në këto net me adhurim.

### Në cilën natë të muajit është ajo?

Dijetarët islamë kanë mendime të ndryshme për këtë çështje. Dikush prej tyre mendon se ajo është në natën e njëzetënjëtë, dikush mendon se është në natën e njëzetetretë, dikush mendon se është në natën e njëzetepesë dhe dikush në të njëzetënjëtë. Por një numër i konsiderueshëm mendojnë se ajo lëviz nga viti në vit. Pra, një vit mund të jetë

në të njëzetënjëtë dhe në vitin tjetër mund të jetë në një natë tjetër. Disa të tjerë mendojnë se ajo është në natën e njëzeteshtatë. Ndër këta janë Ibn Abasi dhe Ubej ibn Ka'bi. Profeti (alejhi selam) ka thënë: "Kush do që ta kërkojë atë, le ta kërkojë në natën e njëzeteshtatë." (Ahmedi) Ubej ibn Ka'bi betohej dhe thoshte se ajo ishte në natën që na urdhëroi Profeti që të bëjmë ibadet, e njëzeteshtatë. (Muslimi)

Nga shenjat e kësaj nate është qetësia shpirtërore që ndjen njeriu në të, lindja e diellit në mënyrë të qartë dhe pa rreze qorruese. Allahu i Madhëruar thotë për këtë natë: "Paqe është ajo deri në lindjen e agimit." [El Kadër: 5]

### Adhurimi në këtë natë

Siç u përmend edhe më lart, në këtë natë pëlqehet adhurimi, si për shembull namazi, dhikri, leximi i Kur'anit, sadakaja etj. Profeti (alejhi selam) ka thënë: "Kush falet në Natën e Kadrit me besim tek Allahu dhe duke pritur shpërblimin prej Tij, atij i falen gjynahet e bëra." (Buhariu)

Aishja një ditë ka pyetur Profetin a.s: "O i Dërguari i Allahut, ç'të them në Natën e Kadrit po e rastisa?" Ai u përgjigj: "Thuaj: "Allahumme inneke afuun tuhribul afue fa'fu anni." Që do të thotë: "O Allah, Ti je falës dhe e do faljen, më fal mua!" (Ahmedi)

### ITIKAFI

Itikaf nga ana gjuhësore do të thotë të qëndrosh mbyllur në një vend, ndërsa në gjuhën e shariatit Islam do të thotë të qëndrosh për një kohë të caktuar brenda në xhami duke bërë adhurime. Imam Ibn Kajjim El-Xhuzijeh, në librin e tij "Zadul mead" thotë: "Qëllimi i itikafit është të lidhësh zemrën me Allahun, duke u vetmuar me Të me adhurime, si dhe duke i ndërprerë lidhjet me krijesat.

Koha e itikafit nuk është e përcaktuar, mund të qëndrohet për një kohë të shkurtër ose të gjatë, sipas nijetit. Prej sunetit (traditës profetike) është të qëndrohet në itikaf 10 ditët e fundit të

Ramazani bashkë me netët e tyre, sepse në to gjendet nata e kadrit. Profeti (alejhi selam) ka hyrë në itikaf në xhaminë e tij çdo Ramazan 10 ditët e fundit, ndërsa në vitin në të cilin ka ndërruar jetë ka hyrë në itikaf 20 ditët e fundit, siç përcillet kjo nga Buhariu.

Itikafi mund të bëhet në çdo xhami në të cilën falet xhumaja dhe pesë namazet e ditës me xhemat. Gjatë itikafit nuk mund të dilet nga xhamia, vetëm nëse është e nevojshme. Gjatë itikafit besimtari duhet të bëjë sa më shumë adhurime, të falë namaze vullnetare, të këndojë Kur'an, të përmendë Allahun sa më shumë, të kërkojë falje për gjynahet dhe t'i drejtohet Atij me lutje të ndryshme.

Itikafi lejohet të bëhet edhe nga gratë. Çdo grua që dëshiron të qëndrojë në itikaf brenda në xhami është e lirë ta bëjë këtë. Aishja r.a ka thënë: "Profeti (alejhi selam) ka qëndruar në itikaf për çdo Ramazan në 10 ditshin e fundit, derisa ndërroi jetë, pas vdekjes së tij kanë qëndruar gratë e tij në itikaf." (Buhariu & Muslimi)

Çdo musliman që futet në itikaf i lejohet të hajë, të pijë dhe të flejë në xhami gjatë kohës së itikafit, por duhet të ketë kujdes të ruajë pastërtinë, rregullin dhe respektin e xhamisë si vend adhurimi. Duhet të kemi parasysh edhe diçka tepër të rëndësishme, nuk lejohet që burri ose gruaja të qëndrojë në itikaf dhe të lërë

mënjatë detyrimet dhe përkujdesjen ndaj familjes, sepse itikafi është sunet, ndërsa kujdesja për familjen është vaxhib (detyrë). Nëse mund të bëhet edhe vaxhibi edhe suneti, atëherë ajo është mirësi e madhe.

### AGJËRIMI I GJASHTË DITËVE TË MUAJIT SHEUAL

Nga punët e pëlqyera pas këtij muaji të begatë është përcjellja e tij me gjashtë ditë agjërime në muajin pasardhës. Kjo mund të kryhet menjëherë pas muajit ditës së Bajramit ose në gjashtë ditë të ndara. Profeti (alejhi selam) ka thënë: "Kush agjëron muajin e Ramazanit dhe e përcjell më pas atë me gjashtë ditë nga muaji Sheual, është sikur ka agjëruar gjithë kohën." (Muslimi)

Këto ishin rregullat kryesore të agjërimit të Ramazanit.

**Mos harroni** se shembulli i këtij muaji është si shembulli i një tregu të hapur, produktet e të cilit shpërndahen falas dhe secilit i jepet mundësia të marrë në të sa të ketë mundësi. Shokët e Profetit e lusnin Allahun gjashtë muaj para se të vinte ky muaj i begatë që ta arrinin atë dhe gjashtë muaj pas tij që t'i pranoheshin punët e tyre.

Lusim Allahun e Lartësuar që të na e lehtësojë agjërimitin e këtij muaji dhe të na pranojë adhurimet në të! Amin uel hamdulil-lahi rabil alemin!

### Tregim nga e kaluara

## Teufiku i vogël dhe gjyshja e vet

Se allafranga, se allaturka...

Ishte fillimi i viteve '70 të shekullit të kaluar dhe para pak vitesh shteti ateist shqiptar në një fushatë të ashpër kundër fesë, ku i ndalonte njerëzit të agjëronin, të faleshin e të festonin. Fushata e raprezaljeve kundër fesë kishte filluar qysh në 1945 me akuza nga më të ndryshme të falsifikuara. Njerëzit ishin të detyruar ta fshihnin besimin dhe të festonin fshehurazi festat fetare, më konkretisht dy bajramet, megjithëse këto nuk shpëtonin pa u marrë vesh nga regjimi i asaj kohe. Një nga shenjat ku merrje vesh, se ishte Bajram ishin furrat e pjekieve të tavave, te cilat ato ditë mbusheshin plot me tava me bakllava, revani e sheqerpare. Edhe gjyshja e Teufikut të vogël kishte bërë sheqerpare dhe e kishte çuar në furrë të piqej. Pasi e mori e përvëloi me sherbet që të ishte gati për ditën e festës. Ndërkaq asokohe familjeve shqiptare iu kishte hyrë varfëria dhe kështu që ishte diçka jo e zakonshme të gatujë ëmbëlsira. Teufikut të vogël i bëri përshtypje dhe e pyeti gjyshen e vet:

- Po me nanën... mos e luj.
- Pse?- Plaka për ta hequr qafe nipin e vogël i thotë:
- Ik andej, se kom ditëlindjen.
- Pas dy muajsh e dhjetë ditësh gjyshja e Teufikut kishte bërë prapë ëmbëlsirë për Kurban Bajram dhe po e përvëlonte me sherbet, kur iu afrua prapë vogëlushi dhe e pyeti:
- Nana, prapë na ke bo ambëlsirë?
- Po me nanën...
- Pse nana?- plaka harron çfarë i kishte thënë Bajramin e Ramazanit dhe i thotë:
- Kom nana ditëlindjen...
- Po ty nana, s'ka shumë që ta festuam ditëlindjen apo harrove?...
- Jo me nanën, se nana asht plakë e nuk e mban mend mirë datën, se allafranga, se allaturka...



- Nana paske bo sheqerpare?

# MËSIMI FETAR ISLAM NË SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME NË LUGINËN E PRESHEVËS

Mësimi fetar në sistemin shkollor në Luginën e Preshevës për herë të parë startoi në vitin shkollor 2001/2002. Padyshim se kjo ngjarje kishte domethënie të veçantë për mbarë banorët shqiptarë të këtyre trevave shqiptare të konfesionit islam. Në paralelet shkollore në të cilat deri para pak kohësh zhvillohej luftë sistematike dhe e pakompromis kundër Islamit, pikërisht në të njëjtat ambiente tani e tutje brezave të rinj nga njerëz kompetentë dhe profesionistë do t'iu prezantohen, predikohen e shpjegohen mësimet e Islamit burimor dhe autentik. S'do mend se ky ishte një sihariq i paimagjinuar për shqiptarët e Luginës së Preshevës, gjë të cilën e kishin ëndërruar breza e gjenerata të panumërta, por që për të ardhur keq, nuk kishin pasur fatin ta shijonin ndonjëherë "ëmbëlsinë" e saj. Fatkeqësisht, një gjë e tillë iu ishte pamundësuar gjatë gjithë kohës së sundimit komunist të asokohshëm dhe një dekadë të plotë pas daljes në skenë të pluralizmit politik në hapësirat ballkanike e më gjerë në Evropën Jug-lindore. Në klasën e parë të ciklit të ulët prindërit janë të obliguar të deklarohen me shkrim, nëse janë për apo kundër vijimit të mësimet fetare nga ana e fëmijëve të tyre. Në momentin e deklarimit pozitiv kjo lëndë për vetë nxënësin bëhet obliguese dhe i njëjti deklarim do të vlejë deri në klasën e katërt të ciklit të ultë. Nga klasa e pestë

Pjesë nga Ligji mbi kishat dhe bashkësitë fetare.  
Liria e predikimit fetar.

**Neni 1.** Çdonjërit në përputhje me Kushtetutën i garantohet e drejta e lirë e ndërgjegjës dhe e besimit.

Liria e besimit përfshin: lirinë që individi të ketë apo jo besim, që të mbajë apo ndërrojë besimin apo bindjen fetare, respektivisht lirinë e besimit apo lirinë e predikimit fetar.

**Neni 15.** Bashkësisë Islame i njihet kontinuiteti me subjektivitet juridik arritur në bazë të ligjit mbi Bashkësinë e fesë islame të Mbretërisë së Jugosllavisë, nrt. 29/1930.

vetë nxënësit janë ata nga të cilët kërkohet deklarimi me shkrim, nëse dëshirojnë të jenë pjesë e vijimit të mësimet fetar. Deklarimi pro mësimet i shpie ata në ndjekjen e mësimet të lëndës në fjalë deri në klasën e tetë të shkollës fillore, kohë kur edhe përfundon mësimi shkollor i ciklit të lartë. Po ashtu edhe në shkollë të mesme kjo lëndë mësohet në të gjitha vitet, respektivisht nga viti i parë deri në vitin e katërt. Edhe këtu, vetë nxënësit deklarohen nëse dëshirojnë apo jo të ndjekin mësim fetar "Ilmuddin". Notimi i nxënësve nga ana profesorëve dhe arsimtarëve bëhet me shkrim. Në Luginën e Preshevës janë gjithsej 20 arsimtarë dhe 8 profesorë të lëndës së mësimet fetar. Kjo lëndë zhvillohet një herë në javë në çdo paralele, ndërsa gjatë vitit nxënësit ndjekin 36 orë mësimi. Numri i përgjithshëm

i nxënësve në Komunën e Preshevës është 4987, ndërsa në atë të Bujanocit 4123. Në Komunën e Medvegjës për shkak të numrit të kufizuar të nxënësve, akoma nuk ka startuar kjo lëndë tejet e rëndësishme. Për përkthimin dhe botimin e librave shkollorë të "Ilmuddin" janë përkujdesur këshillat e Bashkësisë Islame në Preshevë dhe Bujanoc, duke dhënë një kontribut mjaft të çmuar në këtë drejtim.

**RREGULLORJA** mbi shkallën e përgatitjes profesionale të mesimdhënësve për shkollën fillore thotë:

Nga klasa e parë deri në klasën e tetë lëndën e mësimet fetar "Ilmuddin" mund ta japë:

- personi i cili ka të kryer fakultetin teologjik islam;

- personi i cili ka të kryer fakultetin (e ndryshëm), por i cili më parë ka të kryer medresenë (shkollë e mesme fetare);

*Përgatiti: Valdet KAMBERI*

- personi i cili ka të kryer fakultetin dhe i cili është aftësuar për dhënien e lëndës së mësimet fetar.

Marrë në përgjithësi nga të gjitha trevat shqiptare, deri vitin e kaluar aktualisht vetëm në Luginë të Preshevës zhvillohej mësimi fetar nëpër shkolla fillore e të mesme. Viti rrjedhës shkollorë është i dhjeti me radhë, që kur ka nisur të mësohet lëndë fetare "Ilmuddin". Sinjale pozitive në këtë drejtim si duket vijnë edhe nga Maqedonia fqinje. Atje tashmë ka startuar mësimi i lëndës fetare, por qysh nga klasa e pestë. Shpresojmë se në të ardhmen e afërt të përfshihet në të gjitha ciklet mesimore. Janë për t'u përhëndetur dhe meritojnë çdo lëndat angazhimet serioze që po bën Bashkësia Islame e Kosovës për jetësimin në vepër të këtij pikësnyimi madhor duke futur lëndën e mësimet fetar në sistemin shkollor të arsimit të Republikës së Kosovës në të gjitha shkollat fillore dhe ato të mesme të vendit. Urojmë sukses të plotë në këtë përkushtim të vazhdueshëm të Myftiut të Bashkësisë Islame të Kosovës, mr. Naim ef. Tërnavë.

Libri që parashihet me planprogramin e vitit të parë dhe të dytë në shkolla të mesme është "Hyrje në Islam" i autorit dr. Muhammed Hamidullah, ndërsa në vitin e tretë dhe të katërt nxënësit mësojnë nga libri "Islami dhe regjilionet botërore" të autorit boshnjak dr. Xhemaludin Latiq.

## Xhamitë e Tiranës promovojnë javën e "Jeto pastër"



Me nismën e mësueses Enkeleda Matraku dhe me përkrahjen e një grupi prindërisht nga Xhamitë e Tiranës u zhvillua veprimtaria "Jeto pastër". Kjo veprimtari u motivua nga hadithi i mirënjohur "Pastërtia është gjysma e besimit", si dhe njëkohësisht për të promovuar vlerat qytetare në komunitetin ku jetojmë.

Kjo ka qenë një veprimtari e përbashkët fëmijë-prindër në këtë muaj të madhnueshëm të Ramazanit, së bashku me mësuesen e fëmijëve Enkeleda Matraku. Pikënisje kanë qenë xhamitë e kryeqytetit dhe prej aty fëmijët me bluza të bardha janë shpërndarë nëpër rrugët kryesore, duke hequr mbeturinat nëpër rrugë. Kjo

veprimtari ka startuar nga xhamia e Dine Hoxhës, për të vazhduar më tej me xhamitë e Er'hem beut, Kokonozit, Tabakëve e Xhurës.

Për çdo pasdite të kësaj jave grupi i fëmijëve të shoqëruar nga prindërit janë përpjekur të pastrojnë dhe të sensibilizojnë komunitetin rrethorotull për të mbajtur mjedisin e tyre pastër. Ata përveç se kanë pastruar kanë ngjitur parrulla sensibilizuese nëpër vende të dukshme: "Mos ndotni ambientin", "Mbani pastër mjedisin", "Jeto pastër" etj. Gjatë të gjithë kësaj veprimtarie fëmijët kanë hasur në mirëkuptimin dhe miratimin e qytetarëve të Tiranës. Kjo veprimtari është mbështetur edhe nga disa imamë të xhamive të kryeqytetit.

## Prishtina proteston ndaj vrasjeve të fëmijëve në Siri

Pas Tiranës solidarizohet edhe Prishtina me vuajtjet e popullit sirian. Kështu gjarjet e rënda në Siri nuk kaluan pa u ndjerë sado pak edhe nga shoqëria shqiptare. Një proteste simbolike, por që tërhoqi vëmendjen e mjaft qytetarëve e organizuar në Prishtinë në sheshin Skënderbe e bashkoi Prishtinën me kryeqytetet dhe qytetet e tjera në mbarë Evropën dhe botën për t'i thënë ndal vrasjeve të fëmijëve dhe civilëve të pafajshëm sirianë. Në fakt kjo protestë i ka fillesat e saj në Tiranë më dt. 8 Qershor në sheshin me të njëjtin emër Skënderbe. Kjo protestë e nisur nga një qytetare siriane, pikërisht nga qyteti i Halep, ku po zhvillohen luftimet më të ashpra ndërmjet regjimit gjakatar të Asadit dhe kryengritësve. Nisma e qytetare Aliaa Noha gjeti mbështetje edhe nga muslimanët dhe qytetarët, të cilët iu bashkëngjitën protestës me dëshirën e mirë për të kontribuar sado pak në ndalimin e dhunës së pashembullt, që nuk po kursen as fëmijët e vegjël. Foto dhe video tragjike po qarkullojnë që prej më tepër se një viti në internet, ku tregohen rastet e një dhune të pashembullt mbi civilët, dhe ajo që e bën më të dhimbshme është se janë më se 1400 fëmijë të masakruar nga forcat ushtarake të Esedit. Protesta e Tiranës dhe ajo e Prishtinës të ngjashme në formë, por shumë të larta në mesazhin mbarë-shqiptar në shprehjen e solidarizimit me popullin Sirian.

Fëmijë në protestë që qëndrojnë të shtrirë mbuluar me flamuj sirian dhe me lule nga bashkëmohatarët e tyre ka si domethënie të thellë solidarizimin e bashkëmohatarëve shqiptarë me vuajtjet e fëmijëve në Siri. Në Prishtinë kjo mori përmasa edhe më të medha dhe organizimi i 27 korrikut solli në vëmendje edhe një herë, se shqiptarët janë një popull që nuk kanë më kufij mes tyre dhe se reagojnë bashkë kundrejt padrejtësive kudo ku ndodhin. "Ne nuk duam asgjë vetëm se të jetojmë të lirë si çdo popull tjetër- shprehet Aliaa Noha, siriana e natyralizuar shqiptare. Ndërsa organizatori tjetër i kësaj veprimtarie Ilir Hoxholli thotë: "Ne shqiptarët në të dy anët e kufirit i njohim më mirë se kushdo tjetër diktaturën, luftën, mungesën e lirisë... ndaj dhe nuk po bëjmë asgjë më tepër sesa një detyrë qytetare për të sensibilizuar opinionin..."



# A.M.B.C

ALBANIAN MUSLIM BUSINESS CENTRE

[www.lidhjatregtareve.com](http://www.lidhjatregtareve.com)

## DYQANI I MISHIT HALLALL, Kombinat

tregton mish vici, qengji, qofte dhe sallameri te firmes "Meka", me shumice dhe pakice, ofron qengja per kurbane dhe akika.

**Adresa: Rr. Bedri Cullhaj, tek Goni, Xhamia e Kombinatit**  
**Tel: 042350569; Cel: 0672050070; Email: agronxhepa@hotmail.com**

## Libri i Fesë Islame për Fëmijë

Vëllimi II



**Përgatiti: Sektori i Studimeve Islame pranë LSHH**  
**Boton: Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë**  
**Tiranë: korrik 2012**  
**71 faqe**

## PRODUKTE NATYRALE

Produkte bimore të cilësisë më të mirë nga vendet e Lindjes!

Jeni të mirëpritur!

*Në dyqanin tonë do të gjeni:*

- Produkte të firmës "Phenomenal"; vaj të farës së zezë (Habbe Seuda) etj.
- Vajra bimore të firmës "Tact" (mbi 70 lloje bimesh)
- Mjaltë nga lulja e farës së zezë, mjaltë me polen, mjaltë me qumësht blete, mjaltë sidri, etj.
- Hurma arabie të freskëta dhe ujë zemzemi
- Kremra të ndryshëm të firmës "Orchid" dhe shampo
- Vajra el-Bedil, përzierje vajore kundër rënies së flokut
- Parfume vajore (3 ml) me aroma të llojllojshme
- Parfume me mbushje të markave më të njohura europiane
- Misvak dhe pastë dhembesh me misvak
- Këna bimore 100% natyrale për flokë dhe për duar.
- Kohël bimor për sytë etj.

**Adresa: Rr. e Kavajës, rrugica përballë xhamisë "Dine Hoxha", Tiranë**  
**Cel: 0672812607 / 0672821589**

Ky libër vjen si vazhdim i vëllimit të parë në vargun e botimeve në ndihmë të mësimin të Fesë Islame. Ky libër i përgatitur nga sektori i Studimeve Islame është i thjeshtë në formë dhe i vjen në ndihmë mësuesve të fesë për t'ua bërë më të lehtë mësimin e parimeve themelore fëmijëve. Libri është i shtypur i tëri me ngjyra dhe mësimet në të janë thjeshtuar, duke përfshirë edhe udhëzimet për mësuesit.

Mësimet zhvillohen në dy semestra, ku zhvillohen dy lëndë tejet të rëndësishme ajo e Fikhut të thjeshtuar dhe e bazave të teuhidit. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar në bazat e teuhidit njohjes së Zotit dhe të Dërguarit të Tij, si dhe mësimet të ndryshme mbi namazin dhe rregullsinë e tij. Nëpërmjet

ushtrimeve të thjeshta e praktike iu mësohet fëmijëve namazi dhe çfarë duhet të veprohet në të, apo jo. Ky botim vjen në vazhden e botimeve të ndryshme nga Lidhja e Hoxhallarëve për t'i ardhur në ndihmë imamëve dhe besimtarëve.